


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT



OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI

KONTRATË FURNIZIMI

Numri i kontratës ¹: 651-24-4853-1-2-1/C627

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
ES INDUSTRY SH.P.K., Graçanice, Prishtine, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

“Furnizim me Autoambulancë” me numer identifikues: 651-24-4853-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: [dërgesa], [shërbim pas shitjes] nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

“Furnizim me Autoambulancë” - sipas përshkrimit në Aneksin I Specifikat Teknike të detyrueshme të DT si dhe Listës së përshkrimit të çmimeve.

| Nr. | Grupi |
|-----|---------------------------|
| 1 | Furnizim me Autoambulancë |

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1. Afati i fillimit të dërgesës është 5 dite pas nënshkrimit të kontratës, ndërsa afati i përfundimit jo me gjatë se 60 dite nga data e lëshimit të Flete Porosis nga Menaxheri i Kontratës.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - në Komunën e Gjiçanit.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë: DDP (Detyra e Derguar e Paguar).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **59,491.00 €**. Pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një Euro. **Zero zero cent.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare; **10.06.2024**

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

| | | | |
|--------------------|---|--------------------|---|
| Emri: | Kujtim Bjarami | Emri: | Elod Siqani |
| Pozita: | Zyrtar përgjegjës i pranimin | Pozita: | Drejtor |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 01.07.2024 | Data: | 01.07.2024 |
| Vula: |  | Vula: |  |

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|-------------------------------------|-----------|--|
| Përshkrimi i nenit | Nr. Nenit | |
| Ligji zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe. |
| Siguria ekzekutimit | 9.1 | <i>Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës me afat validiteti jo më pak se 95 nga data e nënshkrimit të kontratës.</i> |
| Sigurimi | 10.1 | Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid). |
| Programi ekzekutimit | 11 | <i>[Specifikoni nëse kërkohet programi i ekzekutimit, me data dhe afate kohore, dhe kërkesat në lidhje me ndonjë manual]</i> |
| Tatimet dhe marrëveshjet doganore | 12.1 | DDP (Delivery Duty Paid) |
| Patentat dhe licencat | 13.1 | <i>[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]</i> |
| Cilësia furnizimeve | 18.2 | <i>Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të furnizimit i cili deshton në permbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të percaktuara në specifikimin teknik.</i> |
| Inspektimi dhe testimi | 19.2 | <i>Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës.</i> |
| Pagesa | 20.1 | <i>Pagesat do të bëhen nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorëzuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.</i> |
| Dorëzimi | 21.3 | <i>Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me dërgesën deri në pranimin - në destinacion. Furnizimi duhet të jetë në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tij e deri në destinacionin e caktuar.</i> Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda 60 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00). |

| | | |
|---|------|---|
| Obligimet garancionit e | 24.1 | <i>Sipas KPK-së.</i> |
| | 24.5 | <i>Sipas KPK-së.</i> |
| Shërbimet pas shitjes | 25.1 | Duke u bazuar ne kriterin e dhënie se kontratës TEMF ,afati i i shërbimit pas shitjes-servisimit do te vendoset sipas ofertës se dhene nga OE fitues. Shërbimet pas shitjes servisimi i rregullt sipas manualit te përdorimit te automjetit është 2 vite. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 31.2 | Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtesisë. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 32.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në <i>Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i> ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</i> |

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: ES-Industry Sh.p.k deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) | |
|---|---|
| Emri i OE: | ES- Industry Sh.p.k |
| Adresa e plotë: | Magjistranja Prishtine – Ferizaj Km 8 |
| I përfaqësuar nga: | |
| Emri: | Elod Siqani |
| Pozita: | Drejtor |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 10.06.2024 |
| Vula: |  |

Deklarate reth SPecifikave teknike:


Deklarojme se veture te cilen ne e ofertojme Opel MOvano L2H2 eshte ne perputhje te plote me specifikat teknike te kerkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues, si ne vijim:

| | |
|----|--|
| | AUTOAMBULANCE sipas specifikimit : |
| | Kerkesat Mandatare Teknik |
| 1 | Automjeti duhet te het Autoambulanc |
| 2 | Karakteristikat e hapsires te pasagjerve |
| 3 | Gjateseia ne mes boshteve jo me pak se 3.400mm |
| 4 | Gjateseia jo me pak se 5.400 mm |
| 5 | Gjersia jo me pak se 2.000 mm |
| 6 | Lartesia jo me pak se 2.200 mm |
| | |
| | Dimensionet e mbrendshme |
| 1 | Gjatesia/Gjersia/Lartesia - min 3.000/1.750/1.650 mm |
| 2 | Vellimi min 10 m ² |
| 3 | Modeli (I ri) jo me I vjeter se 2023 (00) km |
| 4 | Eu STD min Euro 5 |
| 5 | Terheqja 2x4 me rrota te para |
| 6 | Fuqia e motorit min 80kW |
| 7 | Nderruesi manual min 6 shpejtesi |
| 8 | Karburanti Diesel |
| 9 | Dyer 2 (para) + nje ansore plus nje mbrapa dy krahshe |
| 10 | Ulese para , ngasesi x 1 dhe ulese per pasagjer dyshe ((per dy persona) |
| 11 | Air begun perpara |
| 12 | Frenim ABS |
| 13 | ESP (Kontrolli Elektronik I Stabilitetit) |
| 14 | Sitemi mbylles qendror me pilot |
| 15 | Ngjyra: E bardh |
| 16 | Timoni hidraulik |
| 17 | Rregullimi I dritave |
| 18 | Dritat per mjegull mbrapa |
| 19 | Klima manuale para |
| 20 | Radio Instalim |

| | |
|----|---|
| 21 | Rrota rezerve |
| | |
| | Pajisjet per Autoambulanc |
| 1 | Rregullimi I mbrendshem (Interieri) |
| 2 | Nxemje shtese mbrapa te hapsira e pacientit |
| 3 | Ftohje shtese mbrapa te hapsira e pacientit |
| 4 | Dritat rotative me ze |
| 5 | Mbishkrimi AMBULANC |
| 6 | Muri ndares me shiber xham |
| 7 | Sistemi per airosje me ventillator ne kulm |
| 8 | Muri I majt I dhomes I ndare per ruajtjen e barnave dhe paisjeve per intervenim |
| 9 | Shtrati levizes per transport te pacientit |
| 10 | Shtylla per vendosjen e infuzionit |
| 11 | Bombola e oksigjenit (nje) 10L me manometer, hapsira te jete per dy bombola |
| 12 | Dy ylse per percjellsit e pacientit |
| 13 | Mekanizmi elektrik 220V per kyqje te paisjeve elektrike |
| 14 | Sistem I pershtatshem ndriqimi ne dhomen e pacientit |
| 15 | DysHEMEJE antibakteriale |
| 16 | Aparat per shuarjen e zjarrit |
| 17 | Pajisjet per trafik komplet |
| 18 | Set per imobilizim te pacientit |
| | |
| 1 | EKG 12 kanaleshe qe interpreton ne ekran minimumi 7 "LCD me ngjyra |
| 2 | Ndertimin e kujtesese per te pakten 30 ecg-se |
| 3 | Shprehja ne format a4 din |
| 4 | Transmetimi I ekg-se regjistrohet me faks (me medem opsional) |
| 5 | Specifikimet : ekg me kanale |
| 6 | 12 kanale te fituara ne te njejten kohe dimensionet rreth 10% |
| | |
| 1 | Defribilator automatik |
| 2 | Aspirtator Portabell-Tensioni operativ 230V-50 Hz Kapaciteti I boces 1 I Rrjedhje: 15 air/min |
| 3 | Thithje max , - 0.85 bar Madhesia:18.5x33x21 cm Pesha 3.8Kg |
| 4 | Materjali : Metal case Nivee te zerit: 55 d BA. |
| 5 | Set per intubim - 1x McIntosh laryngokopa s/s shpatulla N 1,2,3 |
| 6 | 1x Laryngoskop me dorez metal |
| 7 | 1x Magill Pincet |
| 8 | 1x Mbajtese gjuhe |
| 9 | 1x Guedel canula |
| 10 | 1x Hapes goje |
| 11 | 1x Gershere 14.5 cm |
| 12 | Barel per bartje te pacientit - Madhesia e hapjes 219x55x18 cm |

| | |
|----|--|
| 13 | Madhesia e palosur :102x17x14 cm |
| 14 | Pesha: 5.25kg |
| 15 | Ngarkesa: 130Kg |
| 16 | Ambumaske PVC |
| | |
| 1 | Spineboard strecher |
| 2 | Scoop Stretcher |
| 3 | Dafibrilator manual bifazik me monitor |

ES-Industry Sh.p.k
Elod Siqani
Drejtore




Per : Kuvendin Komunal Gjilan

Nr. I Prokurimit 651-24-4853-1-2-1

Deklarate reth Afatit Te Liferimit per tenderin :

Deklarojme se afati I liferimit per veturen veture te cilen ne e ofertojme Opel MOvano L2H2 eshte 30-45 dite nga dita e urdherblerjes.

ES- Industry Sh.p.k
Elod Siqani
Drejtor



PJESA II -PERSHIMI I CMIMEVE - FURNIZIM ME AUTOAMBULANCE

Shënimi: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G ,nuk pranohet që nga OE-t që të bëjnë ndërhjyre në formulat e vendosura nga AK-ja dhe nëse AK-ja dhe nëse AK-ja do të ndërhjyre në formula,ofertat e tilla do të konsiderohet si e pa përgjigjshme.

Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin dubet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore.

| Nr. | PËRSHKRIMI | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|------------------|--|--------|-------|-------------------------|----------------------|-----------------------------|------------------|-----------------|--------------------|
| 1 | FURNIZIM ME AUTOAMBULANCE -sipas përshkrimit ne Aneksit nr.1 | COPE | 1.00 | 55084.26 | 8.00 | 59,491.00 | 55,084.26 | 4,406.74 | 59,491.00 |
| Gjithsej: | | | | | | | 55,084.26 | 4,406.74 | 59,491.00 |



POLICE E SIGURIMIT TE GARANCI KONTRATE



Numri i serise: **BND0016933**

| Data e Leshimit: | Data e Fillimit: | Data e Mbarimit: |
|--------------------------------|--|------------------|
| 01/07/2024 | 01/07/2024 | 04/10/2024 |
| I Siguruari | ES INDUSTRY SH.P.K. | |
| Adresa | LLAPLASELLË, MAGJ.PRISHTINË-SHKUP KM 8 , PN, ,, GRAÇANICË | |
| Numri Unik Identifikues | 811935743 | |
| Perfituesi | KOMUNA E GJILANIT | |
| Titulli i Kontrates | " Furnizim me Autoambulancë " me numer identifikues: 651-24-4853-1-2-1 | |
| Numri i Prokurimit | 651-24-4853-1-2-1/C627 | |
| Numri i Brendshem | | |
| Periudha e Sigurimit | 95 DITE | |
| Shuma e Siguar | 5,949.10 pese mije nenteqind dyzet e nente EUR dhe 10 .cent Euro | |

| Primi | TVSH | Totali | Menyra e pageses | Data e pageses |
|-------|-------|--------|------------------|----------------|
| 89.24 | 16.06 | 105.30 | Xhirrollogari | 01/07/2024 |

Vleren e Siguar,brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga kërkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime,me kusht qe kjo kerkese te permend mos permbushjen e kushteve te kontrates.

Shenime

I siguruari

ES INDUSTRY SH.P.K.



Siguruesi

Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Dega
Kosove

Ilfete Baigora



Me nënshkrimin e kësaj police i siguruari deklaron se:

- Ka lexuar dhe pranuar kushtet e përgjithshme të sigurimit bashkëngjitur.
- Autorizon Siguruesin të përdorë dhe përpunojë të dhënat e tij personale të nevojshme gjatë marrjes në sigurim apo trajtimit të kërkesave për rimbursim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Ka lexuar dhe firmosur procedurën për procesin e ankimit bashkelidhur kesaj police

By signing this policy the insured declared that:

- Has read and accepted the general conditions as attached.
- Authorizes the Insurer to use and process his/her personal data necessary for the underwriting process and /or settlement of the insurance claims in accordance with the terms/conditions of the law in force "On the protection of the Personal data"
- Has read and signed the complaining procedure attached to this policy.

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

POLICA NR. BND0016933



Per: KOMUNA E GJILANIT

(ne vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Ne emer te: ES INDUSTRY SH.P.K. me seli qendrore ne adresen LLAPLASELLË, MAGJ.PRISHTINË-SHKUP KM 8 , P

(ne vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit te prokurimit: " Furnizim me Autoambulancë " me numer identifikues: 651-24-4853-1-2-1

Numri i Prokurimit: 651-24-4853-1-2-1/C627

Numri i Brendshem:

Garancion me kerkese te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndermarre veprimet per te dorezuar nje siguri te ekzekutimit duke iu referuar Dosjes se Tenderit, me numer te prokurimit te lartcekur te derguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik deshiron te depozitoje sigurine ne shumen e saktësuar ne dosjen e tenderit
DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik kete siguri:


ANDAJ NE te poshtenenshkruarit, me kete konfirmojme se jemi garantues dhe pergjegjes para jush, ne emer te operatorit ekonomik, deri ne nje total prej: **5,949.10 pese mije nenteqind dyzet e nente EUR dhe 10 .cent Euro** zotohemi te ju paguajme, qe me kerkesen tuaj te pare me shkrim ne te cilen deklarohet mospermbushja e njerit nga kushtet ne vijim:

a.Autoriteti kontraktues ka konstatuar ne baze te deshmive te vertetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka deshtuar qe te ekzekutoje kontraten e nenshkruar dhe kjo i ka shkatuar autoritetit kontraktues deme substancionale dhe/ose shpenzime te medha per mbylljen e kontrates ne fjale;

b.Operatori ekonomik ka deshtuar qe te ekzekutoje kontraten e nenshkruar dhe si rezultat i saj kane mbet pa u paguar shume punetore, nenkontratore dhe /ose furnizues te materialeve;

Pagesa ne shumen e limituar prej **5,949.10 pese mije nenteqind dyzet e nente EUR dhe 10 .cent Euro** sic eshte lartcekur, do te behet pa asnje kundershtim as ankese, sa me shpejte qe eshte e mundur pas regjistrimit te kerkeses suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri ne daten: 04/10/2024



Nenshkrimi dhe vula e Garantuesit



Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosove
AKTASH RRUGA EDMOND HOXHA NR.27 10000 PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS
DATA E FILLIMIT: 01.07.2024